

## **Hapet thirrja për bursa në programin Erasmus + në Universitetin Ca'Foscari të Venecias në Itali për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.**

Universiteti i Tiranës hap thirrjen për aplikime për bursa për mobilitete në Universitetin Ca' Foscari të Venecias në Itali, në kuadër të programit Erasmus +, për stafin akademik me kohë të plotë të UT-së për mësimdhënie për semestrin e parë të vitit akademik 2019-2020.

### **Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

### **Fusha e studimit:**

- Gjuhë dhe Letërsi;

### **Katalogu i kurseve:**

<https://www.unive.it/pag/17839/>

### **Kohëzgjatja e bursave:**

- Shkëmbimi i stafit akademik (5 + 2 ditë).

### **Bursat përfshijnë:**

- Kompensimin ditor (160 EUR në ditë për stafin)
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të originës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutem referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

## **Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik për mësimdhënie:**

- CV+ lista e publikimeve (në gjuhën angleze/italiane sipas formatit Europass);
- Formulari i aplikimit, sipas linkut:  
[http://www.unitir.edu.al/images/Application\\_Form\\_Ca\\_Foscari.docx](http://www.unitir.edu.al/images/Application_Form_Ca_Foscari.docx)
- Kopje e Pasaportës;
- Letër motivimi (në gjuhën angleze/italiane);
- Certifikata e gjuhës së huaj që vërteton njohuritë e gjuhës angleze/italiane (niveli B2);
- Plan pune në gjuhën Angleze/Italiane;
- Vërtetim punësimi në gjuhën Shqipe dhe të përkthyer në gjuhën Anleze/Italiane;
- Letër suporti nga një pedagog në Universitetin Ca'Foscari (mund të kontaktoni tek: [international.cooperation@unive.it](mailto:international.cooperation@unive.it) duke dërguar CV dhe planin e punës);
- Vetëdeklarim nëse keni kryer më parë ose jo një bursë shkëmbimi Erasmus+ (nëse po, ku);
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie, sipas linkut:

[http://www.unitir.edu.al/images/Mobility\\_Agreement\\_Teaching\\_outgoing.docx](http://www.unitir.edu.al/images/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing.docx)

## **Afati për aplikim: 19 Korrik 2019**

Dokumentet duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Studentët, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikim!